



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-016
Prishtinë, më 8, 9 shkurt dhe 1, 13 e 14 mars 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 8, 9 SHKURT DHE 1, 13 e 14 MARS 2018**

Seancën e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Vjosa Osmani-Sadriu, Rexhep Selimi, Bekim Haxhiu, Milaim Zeka, Daut Haradinaj, Duda Balje, Glauk Konjufca, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Emilija Rexhepi, Islam Pacolli dhe Besa Baftiu, si dhe ministri i Punëve të Brendshme, z. Flamur Sefaj dhe ministri i Shëndetësisë, z. Uran Ismaili, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj i parashtrij pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me projektet e ministrisë rreth orientimit profesional në sistemin arsimor në Kosovë.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me planifikimet strategjike për arsimin parauniversitar në Kosovës, pas rezultateve të PISA-s.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Vjosa Osmani-Sadriu i parashtrroi pyetje ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, në lidhje me rekrutimin dhe numrin e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri Rrustem Berisha iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Mimoza Kusari-Lila i parashtrroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, në lidhje me ndërtimin e një objekti nga ndërmarrja publike rajonale “Radoniqi” në zonën e mbrojtur.

Ministri Valdrin Lluka iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Avdullah Hoti i parashtrroi pyetje ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, në lidhje me veprimet e Qeverisë në procesin gjyqësor nga anulimi i privatizimit të PTK-së në Gjykatën e Arbitrazhit me Axos Capital Partners.

Ministri Abelard Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Bekim Haxhi i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me projektin për modernizimin e kardiologjisë invazive në SHSKUK, të financuar nga Unicredit Bank Austria AG.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigje pyetjes së deputetit.

Deputeti Sami Kurteshi i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me veprimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbulimin e shpenzimeve për ekspertizë të pavarur ndërkombëtare lidhur me vdekjen e aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari.

Ministri Abelard Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Nezir Çoçaj i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me përfshirjen e pedagogëve në procesin edukativo-arsimor.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Nezir Çoçaj i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me trajnimin dhe shpërndarjen e materialeve pedagogjike për stafin profesional të çerdheve.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me 93 ish-punëtorë të KEDS-it, të larguar nga puna në vitin 2016.

Kryeministri nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtrroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, në lidhje me gjendjen jo të mirë të rezervuarit të ujit “Kalaja” në Prizren dhe pajisjeve përcjellëse të tij.

Ministri Valdrin Lluka iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Mirjeta Kalludra i parashtrroi pyetje ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, rreth kërkesave të të burgosurve për pako ushqimore, ditë të lira dhe falje të 25% të dënimeve.

Ministri Abelard Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Zafir Berisha i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, në lidhje me gjetjet e Inspektoratit Policor të Kosovës për policët e kategorizuar si invalidë.

Deputeti Korab Sejdiu i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, në lidhje me veprimet e Qeverisë rreth procedimit për emërimin e Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës.

Ministri Abelard Tahiri i ishte përgjigjur me shkrim pyetjes së deputetit.

Deputeti Korab Sejdiu i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Financave, Bedri Hamza, në lidhje me planet e Ministrisë së Financave pas paraqitjes së kriptovalutave.

Ministri Bedri Hamza nuk i ishte përgjigjur me shkrim pyetjes së deputetit në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

* * *

Në vazhdim, kryesuesi i njoftoi deputetët në lidhje me kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, për shtyrjen për një ditë tjetër të pikës 10 të rendit të ditës: Debat parlamentar, sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues lidhur me Raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës, për shkak të vizitës zyrtare në SHBA.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e nënkryetarit Kujtim Shala në emër të parashtruesve të kërkesës për debatin parlamentar, lidhur me kërkesën e kryeministrit, z. Haradinaj.

Në lidhje me kërkesën e lartcekur të kryeministrit, z. Haradinaj, nënkryetari Kujtim Shala, në emër të parashtruesve të kërkesës për debatin parlamentar u pajtua për shtyrjen e pikës së 10-të të rendit të ditës, si dhe propozoi të shtyhet edhe pika 9 e rendit të ditës: Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.04/20 të datës 20.12.2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24 i datës 12 janar 2018 për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarave që marrin paga nga buxheti i Kosovës, si dhe Vendimi nr. 15/24 i datës 12 janar 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndihmave Sociale.

Më pas, kryesuesi deklaroi që pikat 9 dhe 10 të rendit të ditës shtyhen për seancën e radhës, në të cilën do të jetë i pranishëm kryeministri z. Haradinaj.

* * *

Në vazhdim kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, propozoi të hiqet nga rendi i ditës pika 12: Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Akreditimit. Diskutimi i z. Hoti është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti.

Pas dy votimeve të njëpasnjëshme për propozimin e lartcekur të z. Hoti nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave të Kuvendit të mbajtura më 14 dhjetor 2017 dhe 25 janar 2018, më 25-26 janar dhe më 31 janar e 1 shkurt 2018.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Punëve të Brendshme ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin e drejtësisë për të mitur diskutuan deputetët: Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të GP të PDK-së, Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së, Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së, Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, Bahrim Shabani, në emër të GP të “6+”, Glauk Konjufca, Faton Topalli, Saranda Bogujevci, Sami Kurteshi, Bilall Sherifi, Xhelal Sveçla, Milaim Zeka dhe Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, kërkoi edhe një herë që derisa nuk merret vendimi rreth mocionit të këtij grupi parlamentar për heqjen nga rendi i ditës së pikës 12, të mos vazhdohet me pika të tjera të seancës.

Seanca vazhdoi me pikat e parapara të rendit të ditës, ndërsa Grupi Parlamentar i LDK-së i lëshoi punimet e kësaj seance.

Kryesuesi, pas diskutimeve për këtë projektligj, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, diskutuan deputetët: Ganimete Musliu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe në emër të GP të PDK-së, Sali Salihu, në emër të GP të LVV-së, Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së, Enver Hoti, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, Danush Ademi, në emër të GP “6+” dhe Faton Topalli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi pas diskutimeve për këtë projektligj konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisjet nën presion

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Zhvillimit Ekonomik ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për pajisjet nën presion diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe në emër të GP të PDK-së, Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së, Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, Duda Balje, në emër të GP “6+” dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, votimi në parim i këtij projektligji shtyhet.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Zhvillimit Ekonomik ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për shërbimin gjeologjik të Kosovës diskutuan deputetët Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe në emër të GP të PDK-së, Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi, pas diskutimeve për këtë projektligj, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

8. Debat parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i LVV-së ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik.

Pastaj, kryesuesi e ftoi deputetin Albin Kurti ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Deputeti Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të LVV-së, tha se viti 2015 pati nisur me protestat e janarit që kanë çuar në shkarkimin e ministrit të atëhershëm Jabllanoviq dhe u përmyll me vendimin e Gjykatës Kushtetuese që thoshte se Asociacioni apo Bashkësia e Komunave me shumicë serbe nuk është në përputhje me 23 nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, ai theksoi se viti 2016 pati nisur me demonstratat më të mëdha të Kosovës së pasluftës, më 9 janar dhe 17 shkurt, kundër ‘Zajednicës’ së Serbisë dhe demarkacionit me Malin e Zi. Gjatë asaj kohe janë bërë me qindra arrestime të aktivistëve e deputetëve opozitarë, deri më 29 gusht të vitit 2016, kur arrestohen 6 aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje” për sulmin me predhë në ndërtesën e Kuvendit më 4 gusht. U arrestuan Astrit Dehari, Frashër Krasniqi, Atdhe Arifi, Egzon Haliti, Adea Batusha dhe Petrit Ademi.

Policia e Kosovës organizonte konferenca për shtyp dhe emisione televizive, ku zyrtarët më të lartë të saj sulmonin publikisht aktivistët e arrestuar dhe subjektin tonë politik. Dendësi të tillë të deklaratave publike nga Policia e Kosovës, sidomos nga e ashtuquajtura “Njësi Kundër Terrorizmit”, nuk ka pasur as më herët dhe as më vonë në Kosovë sikur me rastin e arrestimit të këtyre 6 aktivistëve.

Arrestimi i 6 aktivistëve ngjau vetëm dy ditë para protestës së 1 shtatorit 2016 kundër ratifikimit të demarkacionit këtu në Kuvend. Dhe, si për çudi, sërish vetëm dy ditë para balotazhit në zgjedhjet lokale, pra më 17 nëntor 2017, këta aktivistë dënohen gjithsej me 21 vjet burgim, pasi që Astrit Dehari ishte mbytur në burg një vit më parë.

Dënimi nuk u dha pse ai kishte rëndësi për ligjin, shoqërinë dhe të pandehurit, por pse ai kishte rëndësinë për Policinë, e cila moti kishte ndëshkuar e dënuar aktivistët. Kur vdiq Astriti, nuk foli as gjyqësia, as prokuroria, as ministria, as burgu, por Policia. Foli komandanti i Policisë i rajonit të Prizrenit. Diskutimi i deputetit Albin Kurti është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me çështjen e ngritur për debat parlamentar.

Lidhur me dënimin e disa aktivistëve të LVV-së diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Hajdar Beqa, Bilall Sherifi, Arbër Rexhaj, Milaim Zeka, Xhelal Sveçla, Sami Kurteshi, Glauk Konjufca, Rexhep Selimi, Dardan Molliqaj, Daut Haradinaj, Ismajl Kurteshi dhe Arbërie Nagavci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Deputeti Sami Kurteshi, në emër të propozuesit të çështjes për debat parlamentar, i lexoi rekomandimet dhe kërkoi nga deputetët që t’i miratojnë.

Kryesuesi, pas diskutimeve, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

11. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryesuesi e ftoi kryetaren e Komisionit FunkSIONAL ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

Kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, Duda Balje, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës. Diskutimi i saj është dhënë në transkript.

Pastaj kryesuesi e hapi debatin lidhur me rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Lidhur me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës diskutuan deputetët: Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së, Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të GP të PDK-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, Duda Balje, në emër të GP të “6+”, Albulena Haxhiu, Luljeta Veselaj-Gutaj, Muharrem Nitaj, Islam Pacolli, Enver Hoti, Sala Berisha-Shala, Bilall Sherifi, Bekim Haxhiu dhe Hajdar Beqa, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Deputetja Duda Balje, në emër të Komisionit FunkSIONAL, i lexoi rekomandimet dhe kërkoi nga deputetët që t’i miratojnë.

Kryesuesi, pas diskutimeve, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

13. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe raportit të pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe raportin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

Deputeti Mërgim Lushtaku, në emër Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016. Diskutimi i tij është dhënë në transkript.

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016. Diskutimi i saj është dhënë në transkript.

Kryesuesi, pas diskutimeve, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, si dhe i ndërpreu punimet e kësaj seance.

* * *

E premte, më 9 shkurt 2018

Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 8 shkurt 2018

Vazhdimin e seancës plenare të filluar më 8 shkurt 2018 e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se për pikat: 4, 5, 6, 7, 8, 11 dhe 13 të rendit të ditës diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare më 8 shkurt 2018, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje nuk janë vënë në votim, andaj në seancën e sotme do të bëhet votimi i tyre si dhe do të shqyrtohen pikat 12 dhe 14, ndërsa pikat 9 dhe 10 mbesin për një ditë tjetër.

Kryesuesi procedoi me rendin e ditës, si në vijim:

4. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 60,
Kundër-----7,
Abstenime ----- 3.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt.

2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. *Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore*

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 69,
Kundër-----0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. *Votimi në parim i Projektligjit për pajisjet nën presion*

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër-----0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore.

2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Votimi në parim i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër-----0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Votimi i rekomandimeve lidhur me debatin parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në seancën e djeshme janë lexuar rekomandimet e Grupit Parlamentar të LVV-së lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e rekomandimeve të propozuara nga Grupi Parlamentar i LVV-së.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 40,
Kundër-----10,
Abstenime -----13.

Kuvendi me shumicë votash nxori këto:

REKOMANDIME

1. Për rastin e sulmit në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 4 gusht 2016, të kërkohet dhe të mundësohet një hetim i plotë i pavarur ndërkombëtar i tërë rastit nga ndonjëri prej vendeve perëndimore të Bashkimit Evropian, përfshirë vendet neutrale të Evropës Perëndimore dhe Zvicrën, por këtë duke e veçuar nga rasti i Astrit Deharit.
2. Shkarkimi i të gjithë personave nga Policia e Kosovës, të involvuar në këtë rast të inskenuar.
3. Shkarkimi dhe suspendimi i të gjithë personave që kanë qenë kompetentë dhe përgjegjës në hierarkinë shtetërore kur ka ndodhur rasti i Astrit Deharit.

11. Votimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i hodhi në votim rekomandimet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 57,
 Kundër-----0,
 Abstenime -----13.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratoohen rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

13. Votimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe raportit të pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016

Kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe raportin e pasqyrave financiare të auditura për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 65,
 Kundër-----2,
 Abstenime -----5.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe raporti i pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

14. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Kuvendit e ftoi kryetarin e Komisionit FunkSIONAL ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Daut Haradinaj, e paraqiti dhe e arsyetoi rekomandimin e Komisionit FunkSIONAL lidhur me raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016. Diskutimi i tij është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin lidhur me raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016.

Lidhur me raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016 diskutuan deputetët: Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së, Andin Hoti, në emër të GP të PDK-së, Enver Hoti, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, Danush Ademi, në emër të GP “6+”, Xhelal Sveçla, Nezir Çoçaj, Shqipe Pantina, Islam Pacolli, Driton Çausi, Emilija Rexhepi, Salih Salihu, Drita Millaku dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi, pas diskutimeve, konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës plenare më 9 shkurt 2018, në orën 18:35.

* * *

E enjte, më 1 mars 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e kryesoi z. Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi në fillim të seancës fjalën ia dha deputetes Albulena Haxhiu.

Deputetja Albulena Haxhiu, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” paraqiti mocionin për shtyrjen e pikës së rendit të ditës: “Interpelanca e kryeministrit të Republikës së

Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari”, për seancën e radhës.

Në vazhdim kryesuesi kërkoi deklarinimin e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me mocionin e paraqitur nga deputetja Haxhiu.

Lidhur me mocionin diskutuan deputetët: Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit, Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së, Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së, Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së, Sasha Milosavljeviq, në emër të GP të Listës serbe, Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën” dhe Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim mocionin e propozuar.

Kuvendi e miratoi me shumicë votash mocionin e GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” për shtyrjen e pikës së rendit të ditës: “Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari”, për seancën e radhës.

Kryesuesi procedoi me rendin e ditës, si në vijim:

9. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.04/20 të datës 20.12.2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24 të datës 12 janar 2018 për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarave që marrin paga nga buxheti i Kosovës, si dhe Vendimi nr. 15/24 i datës 12 janar 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndhimave Sociale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se GP i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe GP i Lëvizjes “Vetëvendosje” kanë parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin Ramush Haradinaj lidhur vendimet e lartshënuara të Qeverisë së Kosovës.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, tha se kryeministri është thirrur në interpelancë, sepse ne vlerësojmë se ky vendim është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Ai tha se në mandatin e kaluar Kuvendi e ka ndryshuar Ligjin për menaxhimin e financave publike, me nenin 22 c që lidhet me kufizimin e rritjes së pagave. Në pikën 1 theksohet se “rritja e pagave në baza vjetore nuk tejkalon normën e rritjes së bruto prodhimit vendor”.

E dyta, përveç që bie ndesh me Ligjin për menaxhimin e financave publike, vendimi i Qeverisë është në kundërshtim me etikën qeverisëse dhe është konflikt i hapur interesit.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, në nenin 9, thekson: “Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit të lartë i ndalohet të marrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t’i përshtaten interesit të tij personal apo personave të afërt dhe të besueshëm”.

E treta, vendimi i qeverisë i tejkalon kompetencat e përcaktuara me Rregulloren e Punës së Qeverisë, e cila në asnjë dispozitë të saj nuk përcakton kompetenca dhe përgjegjësi të Qeverisë për caktimin e pagave për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar.

E katërta, pavarësisht këtyre argumenteve për shkelje, ky vendim është i papranueshëm, pasi krijon një diferencë të madhe me elemente diskriminuese në mes të të ardhurave të grupeve të ndryshme shoqërore me pagat e zyrtarëve të Kabinetit qeveritar.

Vendimi i tillë është i pamatur, pasi krijon implikime financiare pa mbulesë.

Nisur nga këto argumente dhe në përputhje me nenin 44 të Rregullores së Kuvendit, Grupi ynë Parlamentar kërkon që Qeveria të anulojë menjëherë vendimin e kundërligjshëm për rritjen e pagave Kabinetit qeveritar dhe në afatin sa më të shkurtër të sjellë para Kuvendit Ligjin për pagat në sektorin publik. Diskutimi i deputetit Avdullah Hotit është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi pastaj e ftoi edhe deputeten Albulena Haxhiu që ta paraqesë gjithashtu edhe qëndrimin e GP të LVV-së si bashkëpropozues të interpelancës.

Deputetja Albulena Haxhiu tha se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka dërguar në Agjencinë Kundër Korrupsionit Vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave, për shkak se përmbajtja e këtij vendimi përbën shkelje sipas kuptimit të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më pas ajo theksoi se Agjencia Kundër Korrupsion më 29 janar ka konsideruar që ky vendim është i paligjshëm, rrjedhimisht Qeveria ka konsumuar veprën penale të konfliktit të interesit dhe ne kemi kërkuar po ashtu nga Agjencia Kundër Korrupsion që të deponojë kallëzimet penale për kryeministrin dhe ministrat që kanë marrë pjesë në këtë vendim. Ne, po ashtu, si grup parlamentar, bashkë me tre deputetët e LDK-së e kemi proceduar në Gjykatën Kushtetuese këtë vendim, për shkak se i njëjti është në shpërputhje me Kushtetutën, sepse cenon kompetencat e Kuvendit, por po ashtu është në shpërputhje me standardet socio-ekonomike.

Ne kemi kërkuar po ashtu rezolutë, si dhe mbështesim pikat apo propozimet e LDK-së që i ka proceduar në interpelancë, edhe për shfuqizim të vendimit për paga, por po ashtu edhe për nxjerrjen e Ligjit për pagat, procedimin e tij dhe po ashtu kemi propozuar tri pika. Diskutimi i deputetes Albulena Haxhiu është dhënë i plotë në transkript.

Në vazhdim kryesuesi e ftoj kryeministrin Ramush Haradinaj ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë.

Kryeministri Ramush Haradinaj theksoi se rritja e pagave të Kabinetit qeveritar ka ndodhur me një vendim të Qeverisë, në përputhje me praktikën e marrjes së vendimeve të tilla dhe si i këtillë ka mundësuar nivelimin e pagave. Në listën e renditjes së nivelit të pagave kryeministri i Kosovës është numër 69 me vendimin e mëhershëm, pra janë 69 zyrtarë të tjerë që marrin pagë më të madhe se kryeministri.

Kryeministri tha se në bazë të renditjes së përgjegjësive dhe në bazë të rangut të përgjegjësive që mban zyrtari shtetëror, kryeministri i vendit, ministri, kryetari i Këshillit Gjyqësor, ai i Këshillit Prokurorial, nuk mund të jenë numër 69.

Tani gjendja është kështu: ky vendim, pra kjo temë është në Gjykatën Kushtetuese, unë pres përgjigjen e gjykatës, e kemi pezulluar, sido që të vendosë gjykata, ne e respektojmë, mirëpo mos harroni, edhe një herë ju them që është e habitshme, pra indiferenca që ka ndodhur në të kaluarën, po e lëmë këtë rast kryeministrin ose po e lëmë ministrin, por kryetari i Këshillit Gjyqësor dhe kryetari i Këshillit Prokurorial të lihen numër 69 në rangim të listës së pagave. Diskutimi i kryeministrit Ramush Haradinaj është dhënë i plotë në transkript.

Lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë, diskutuan: Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së, Lumir Abdixhiku, në emër të GP të LDK-së, Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së, Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së, Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, Ramush Haradinaj, kryeministër i Kosovës, ministri Bedri Hamza, Skender Reçica e Mahir Yagcilar, si dhe deputetët Shqipe Pantina, Lirije Kajtazi, Bekim Haxhiu, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Fitore Pacolli, Haxhi Avdyli, Sali Zyba, Driton Selmanaj, Drita Millaku, Hykmete Bajrami, Ismajl Kurteshi, Armend Zemaj, Arbërie Nagavci, Korab Sejdiu dhe Besa Baftiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi ia dha fjalën kryeministrit për të dhënë opinionin përfundimtar lidhur me temat e interpelancës. Diskutimi i plotë i kryeministrit z. Haradinaj është dhënë në transkript.

Në vazhdim kryesuesi ua dha fjalën propozuesve të interpelancës

Deputetja Albulena Haxhiu, në emër të propozuesve të interpelancës i paraqiti rekomandimet e harmonizuara të dy grupeve parlamentare, LDK dhe LVV.

Kryesuesi i hodhi në votim rekomandimet e propozuara.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 16:00.

* * *

Seancën plenare e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari procedoi me rendin e ditës, si në vijim:

9. Votimi i rekomandimeve të interpelancës lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.04/20 të datës 20.12.2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24 i datës 12 janar 2018 për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarave që marrin paga nga buxheti i Kosovës, si dhe Vendimi nr. 15/24 i datës 12 janar 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndhimave Sociale

Kryetari fillimisht ia dha fjalën deputetes Albulena Haxhiu për t'i paraqitur rekomandimet e harmonizuara të grupeve parlamentare të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Deputetja Haxhiu i lexoi rekomandimet e harmonizuara të dy grupeve parlamentare (LVV dhe LDK) lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 04/20 të datës 20.12.2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24 i datës 12 janar 2018, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarave që marrin paga nga buxheti i Kosovës, si dhe Vendimi nr. 15/24 i datës 12 janar 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në skemën e ndihmave sociale.

Në vazhdim kryetari i hodhi dy herë radhazi në votim rekomandimet e propozuara, mirëpo në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, nuk u votuan këto rekomandime.

10. Debat parlamentar, sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues lidhur me raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës

Kryetari fjalën ia dha kryetarit të GP të LDK-së, Avdullah Hoti, për paraqitjen e çështjes për të cilën është kërkuar debati.

Avdullah Hoti, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës deklaroi se nuk mund të vazhdohet me këtë pikë të rendit të ditës, pa marrë vendim Kuvendi rreth rekomandimeve për interpelancën.

Lidhur me këtë çështje diskutuan deputetët: Milaim Zeka, Glauk Konjufca, Teuta Haxhiu dhe Hajdar Beqa, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari i ndërpreu punimet e seancës plenare më 13 mars 2018 në orën 10:50 dhe i njoftoi deputetët se seanca do të vazhdojë më 14 mars 2018, në orën 10:00.

* * *

E mërkurë, më 14 mars 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Kryetari procedoi me rendin e ditës, si në vijim:

9. Votimi i rekomandimeve të interpelancës lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.04/20 të datës 20.12.2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24, i datës 12 janar 2018, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarave që marrin paga nga buxheti i Kosovës, si dhe Vendimi nr. 15/24 i datës 12 janar 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në skemën e ndihmave sociale

Kryetari i hodhi në votim rekomandimet e harmonizuara të grupeve parlamentare të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 49,
Kundër-----58,
Abstenime -----0.

Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet e propozuara nga grupet parlamentare të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës.

10. Debat parlamentar, sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues lidhur me raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës

Kryetari e ftoi parashtruesin e kërkesës për debat parlamentar që ta marrë fjalën.

Kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, tha se koalicioni qeveritar është themeluar për punë të mëdha: themelimi i shpejtë i Forcave të Armatosura të Kosovës, zotimi se kufiri me Malin e Zi do të vendoset në Çakorr e në Kullë, heqja e vizave për 90 ditë, rritja e pagave për 30%, rritja e pensioneve për 25%, ulja e importeve me Serbinë, rifunksionalizimi i Trepçës, gjetja e zgjidhjes për pensionistët minatorë brenda 90 ditëve.

Në vend të realizimit të punëve të mëdha, kryeministri është kujdesur që të emërojë pesë zëvendëskryeministra, 21 ministra dhe mbi 70 zëvendësministra në Qeveri. E ka urdhëruar ministrin e Arsimit të shkarkojë Bordin e Agjencisë së Akreditimit dhe kemi debatuar pasojat e kësaj në këtë Kuvend. E ka dyfishuar pagën për vete dhe për vartësit e tij, vendosi të falë 58 milionë të hyra të parapara për buxhet, importet nga Serbia u rritën për 50% krahasuar me janarin 2017, Bordi i “Trepçës” nuk u funksionalizua.

Këto dhe vendime të tjera dhe i gjithë raporti 100-ditor reflektojnë mungesën e kompetencës për të qeverisur, reflektojnë mashtrimet elektorale.

Këto janë arsye të mjaftueshme se kjo qeveri nuk di të udhëheqë, kjo qeveri nuk duhet të udhëheqë, kjo qeveri nuk i përmbush pritjet për integritime euro-atlantike që kanë qytetarët e Kosovës. Prandaj, unë sot ftoj që të bëhemi të gjithë bashkë, të marrim disa vendime të mëdha, siç është ratifikimi i demarkacionit dhe të organizojmë sa më parë zgjedhje të lira. Diskutimi i deputetit Avdullah Hotit është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari e ftoi kryeministrin Ramush Haradinaj ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjen e ngritur për debat parlamentar.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se e vërteta është se janë disa tema që e rëndojnë Kosovën, e kanë rënduar. Ju e cekët dialogun, është temë që vazhdon, që e rëndon Kosovën dhe besoj që është mirë që në Parlament kemi diskutim për dialogun, pra të diskutojnë një herë grupet parlamentare, të gjithë, dhe ndoshta të vendosim si do të përfaqësohemi në dialog, që LDK-ja të ketë njerëzit e vet, edhe “Vetëvendosja”, të mos jetë dialogu i njerit prej neve, por i të gjithëve, mendoj se do të ishte në dobi për vendin.

Edhe demarkacioni me Malin e Zi e ka rënduar Kosovën, e rëndon edhe sot, vërtet që Qeveria aq sa ka mbërritur dhe sa ka pasur mundësi dhe hapësirë vepruese, ka ndihmuar që kjo temë ta marrë epilogun e duhur.

Sa i përket ushtrisë, po më vjen keq që më duhet ta them e ta përsëris, por është LDK-ja ajo që e ka lënë Kosovën pa ushtri.

Para disa ditësh e kemi nënshkruar një projekt, të cilin edhe ju keni meritë, LDK-ja. Ai projekt është Parku Inovativ Trajnues në Prizren. Është nisur në qeveritë e mëhershme, e kemi kryer.

Qeveria e vendit është në telashe. Arsimi s’është mirë. Po punojmë, nuk po themi se çdo veprim është perfekt. Në shëndetësi kemi vështirësi, se gjendja është e rëndë, e kemi gjetur qysh e kemi gjetur. Në të gjitha jemi duke punuar. Nëse jeni të interesuar të debatonit për tema konkrete të qeverisjes, beso, s’përtojmë. Fjala e plotë e kryeministrit është dhënë në transkript.

Lidhur me raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës diskutuan: Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së, Lumir Abdixhiku, në emër të GP të LDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së, Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së, Milaim Zeka, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, Ismet Beqiri, Arbër Rexhaj, Driton Selmanaj, Blerim Kuçi, Evgjëni Thaçi, Albin Kurti, Mimoza Kusari-Lila, Luljeta Veselaj-Gutaj, Rasim Selmanaj, Dardan Sejdiu, Vjosa Osmani, Bekim Haxhiu, Ali Lajçi, Hykmete Bajrami, Xhevahire Izmaqi, Teuta Haxhiu, Enver Hoti, Drita Millaku, Arben Gashi, Emilija Rexhepi, Nezir Çoçaj, Arbërie Nagavci, Time Kadrijaj, Milaim Zeka, Danush Ademi Salih Zyba, Haxhi Avdyli, Hajdar Beqa, Shemsi Sylaj, Labinot Tahiri, Armend Zemaj, Shkumbin Demaliaj, Fidan Rekaliu, Xhelal Sveçla, Naser Rugova dhe Besa Gaxherri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e përmbylli debatin parlamentar për këtë çështje.

12. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Akreditimit

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe ta arsyetojë vendimin.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës deklaroi se Qeveria e tërheq nga rendi i ditës Vendimin e Qeverisë për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Akreditimit.

14. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016

Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, kryesuesi deklaroi se ky votim shtyhet për seancën plenare më 15 mars 2018, si pikë e fundit e rendit të ditës.

Kryesuesi i mbylli punimet e kësaj seance më 14 mars 2018, në orën 18:30.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*